



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1517/2 prot

Datë 04.07.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Aida Construction” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-72128-06-09-2023, me objekt: “Rehabilitimi i stacioneve të autobuseve dhe i stacionit të taksive elektrike të Segmentit nga Shkolla e Marines deri të Regina City” me fond limit 5,833,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 23.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Haziri” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar

Ankimues: “B93 II” SHPK
Rruga “Margarita Tutulani”, pslldi “Kaso”, Apartamenti nr.76, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlorë
4 Heronjte Rruga “Osmen Haxhiu”, Vlorë

Subjekte të Interesuara: “Aida Construction” SHPK
Fier, “Rr Brigada XI Sulmuese” Lagjia Apolonia, pallati në krah të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, 9301, Bashkia Fier

“Haziri” SHPK
Kukes, Gjinaj, Lagjia Haziraj, Rruga Nacionale Kukes-Gjinaj, Km5, Zona Kadastrale Nr.2282, Nr. Pasurie 11/10

Në datën 03.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr.1517 prot., e operatorit ekonomik “B93 II” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”,

me Nr. REF-72128-06-09-2023, me objekt: “Rehabilitimi i stacioneve te autobuseve dhe i stacionit te taksive elektrike te Segmentit nga Shkolla e Marines deri te Regina City” me fond limit 5,833,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 23.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Aida Construction” SHPK dhe “Haziri” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “B93 II” SHPK me anë të ankesës me nr. 1517 protokollit, datë 03.07.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë Aida Construction” SHPK dhe “Haziri” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për operatorët ekonomikë “Aida Construction” SHPK dhe “Haziri” SHPK, si më poshtë:

Na lind e drejta të kërkojmë skualifikimin e dy operatorëve të tjerë pasi kualifikimi i tyre është i padrejtë dhe se kanë paraqitur oferta ekonomike të pabazuara në projektin përkatës dhe në preventiv.

Ndërsa për kriteret e vecanta të kualifikimit shoqëritë” Aida Construction” SHPK dhe “Haziri” SHPK nuk i plotësojnë sipas dst të kërkuara në tender.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 04.07.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri